



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/77

Datë: 04.03.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 15 të Ligjit 03/L-049 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenit 14 të Rregullores nr. 06/2010 për procedurat e emërimit në pozita të larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 4 mars 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Z. Xhafer TAHIRI emërohet Drejtor i Përgjithshëm në Agjencinë për Pronësi Industriale, në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi zgjat tre (3) vjet.
3. I emëruari nga pika 1. e këtij vendimi kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/77

Datë: 04.03.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës me plotësimet dhe ndryshimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 4 mars 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës shkarkimin e z. Bajram ZOGIANI nga pozita e anëtarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Policia e Kosovës, Njësi për Hetimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore, më datën 24 Dhjetor 2014, me dyshimin për Trafikim me Qenie Njerëzore, kishte arrestuar në vendin e tij të punës z. Bajram ZOGIANI, anëtar i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).

Që atëherë, z. ZOGIANIT i ishte caktuar dhe vazhduar disa herë masa e paraburgimit për të njëjtin dyshim dhe vitin e kaluar kundër tij dhe të tjerëve, Prokuroria e Shtetit ka ngritur Aktakuzë, ndërsa shqyrtimi gjyqësor në këtë çështje penale nuk ka përfunduar akoma.

Arrestimi dhe paraburgosja e z. ZOGIANI me dyshimin për përfshirjen e tij në Trafikim me Qenie Njerëzore, përveç dëmtimit të imazhit të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik dhe rritjes së klimës së mosbesimit të publikut në këtë institucion, poashtu ka ndikuar për të keq edhe në funksionimin e OSHP-së sepse posti i z. ZOGIANI ka ngelur vakant dhe asnjëherë deri më tani nuk ishte plotësuar me anëtar të ri.

Për më tepër, z. ZOGIANI në mungesë të një vendimi meritor të Kuvendit të Republikës të Kosovës për suspendimin apo largimin e tij nga pozita e anëtarit të OSHP, ai edhe sot e kësaj dite, përkundër faktit që është i akuzuar dhe nën masën e paraburgimit për plot 14 muaj, vazhdon të marrë pagën e plotë sikurse çdo anëtar tjetër aktiv i OSHP-së.

Qeveria e Republikës së Kosovës, vlerëson se qëndrimi i z. ZOGIANI edhe më tutje si anëtar i OSHP, përveç ndikimit të keq në vlerësimin publik të OSHP-së dhe shfrytëzimit të buxhetit të këtij institucioni, ani pse nën masën e paraburgimit, me hyrjen në fuqi të ligjit Nr. 05/L-092, Për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-042 Për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237 dhe me ligjin Nr. 05/L-068, poashtu është në papërshtatshmëri ligjore me këtë ligj, sepse me nenin 3 të këtij Ligji, me të cilin është ndryshuar neni 100 i Ligjit bazik, në paragrafin 4, pika 4.2 e nenit 100 të ligjit bazik, një nga kriteret që duhet plotësuar Kryetari apo Anëtar i OSHP-së është edhe kriteri që:

"Të mos jetë i dënuar për ndonjë vepër penale ose mos të jetë i akuzuar për ndonjë vepër penale"

Qeveria e Republikës së Kosovës, e përkushtuar për të siguruar një funksionim të plotë e të pavarur të Organit Shqyrtues të Prokurorit Publik (OSHP), me qëllim që të mbrohen interesat e të gjithë operatorëve ekonomikë që marrin pjesë në aktivitetet e Prokurimit Publik dhe sigurohet një shpenzim sa më efikas dhe transparent i parasë publike, në mbështetje të nenit 4 të ligjit Nr. 05/L-092, Për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-042 Për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237 dhe me ligjin Nr. 05/L-068, me të cilin Qeverisë së Republikës së Kosovës i është dhënë kompetencë për t'i propozuar Kuvendit të Republikës së Kosovës shkarkimin e kryetarit apo anëtarit të OSHP-së, propozon që z. Bajram ZOGIANI të shkarkohet nga pozita e anëtarit të OSHP-së, sepse qëndrimi i tij edhe më tutje si anëtar me pagë të plotë në këtë institucion, është në papërshtatshmëri ligjore.

Qeveria e Republikës së Kosovës, me këtë propozim drejtuar Kuvendit, në asnjë mënyrë nuk paragjykon fajësinë e z. ZOGIANI për përfshirjen e tij në veprën penale për të cilën akuzohet dhe respekton plotësisht parimin kushtetues të prezumimit të pafajësisë, por në të njëjtën kohë gjykon se shkarkimi i z. ZOGIANI si anëtar i OSHP dhe emërimi i një anëtar të ri në vend të tij, në përputhje me ligjin, përveç tjerash do t'i kontribuonte përmirësimit të imazhit të OSHP-së dhe do të ndikonte në funksionimin e plotë të tij ashtu siç kërkohet me ligj.

Për arsyet e lartpërmendura, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 101 paragrafi 4 lidhur me nenin 100 paragrafi 4 pika 4.2, të ligjit bazik, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 05/L-092, Për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-042 Për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237 dhe me ligjin Nr. 05/L-068, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/77

Datë: 04.03.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 17 të Ligjit nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, nenit 8 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 4 mars 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen shtesat mbi pagën bazë për kushtet e tregut të punës për listën e pozitive të nëpunësve civilë në Ministrinë e Financave, sipas aprovimit të Komisionit të përbashkët të Ministrisë së Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave.
2. Vlera e shtesës do të jetë 50 % mbi pagën bazë.
3. Ministria e Financave duhet të sigurojë mjetet e nevojshme buxhetore për pagesën e këtyre shtesave brenda ndarjeve buxhetore për vitin 2016 nga kategoria paga dhe mëditje.
4. Ky vendim vlen nga data 01.02.2016 deri më datë 31.12.2016.
5. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë